

01

UDHËZUES XHEPI
PËR SIGURINË

Përmbajtja e
bombulave të gazit

MESSER 
Gases for Life



Të nderuar konsumatorë të gazeve Messer,

Messer prodhon dhe furnizon një gamë të gjerë gazesh. Gazet janë të sigurt për tu përdorur - për sa kohë që ju respektoni vetitë e tyre të veçanta.

Çdo gaz ka vetitë e tij, gjë që ofron avantazhe, por gjithashtu shkakton rreziqe të konsiderueshme. Gjithashtu kini parasysh se gazi brenda bombulës së gazit është nën presion të lartë.

Prandaj është thelbësore që të njiheni me vetitë e gazit në bombulën tuaj të gazit nën presion. E njëjta gjë vlen edhe për rreziqet që lidhen me të.


Ky udhëzues xhepi ju ofron informacione se si të identifikoni shpejt rreziqet dhe risqet që lidhen me gazet që jeni duke përdorur dhe ka për qëllim plotësimin e dispozitave rregullatore.

Ju lutemi rruani këtë fletë sigurie në mënyrë që ta aksesoni lehtë në çdo kohë.

E rëndësishme

Me çdo produkt, Messer ju siguron një fletë të dhënash sigurie që përmban udhëzime të rëndësishme sigurie mbi gazet. Ju lutemi të njiheni me këtë informacion.

Ekipi Juaj Messer



Porositja e bombulave të gazit

Për të furnizuar produktin e duhur na duhen informacionet si më poshtë

- Emri i gazit dhe pastërtia e dëshiruar
- Madhësia e bombulës së gazit e matur në litra
- Presioni i dëshiruar (e.g. 150, 200 ose 300 bar)
- Lidhës i ventilit

Stafi i Messer-it do t'ju ndihmojë me kënaqësi të zgjidhni produktin e saktë.

Marrja e bombulave të gazit


Sigurohuni që etiketa e bombulës të jetë e pranishme dhe lehtësisht e lexueshme. Nëse etiketa është e palexueshme ose mungon, mos e përdorni këtë bombulë gazi. **Shkëmbeni** bombulën e gazit për një bombulë me një etiketë që është në gjendje të mirë.

Sigurohuni që emri i gazit në etiketën e bombulës të përputhet me porosinë tuaj.

Si një përdorues i ri, duhet të pajiseni me **fletën përkatëse të të dhënave të sigurisë (FDS)** që përmban udhëzime të mëtejshme të sigurisë për gazin që keni marrë.

Kontrolloni numrin UN (numrin material) për të parë nëse përputhet me numrin UN në FDS dhe në fletën e dorëzimit.

Shembull i një etikete



Informohuni mbi:

- vetitë e gazeve dhe rreziqet që lidhen me to
- fletën e të dhënave të sigurisë
- transportin e sigurt, ngarkimin dhe shkarkimin e bombulave të gazit
- magazinimin e sigurt të bombulave të gazit
- përdorimin e sigurt të bombulave të gazit dhe pajisjeve përkatëse
- masat e emergjencës



Gaze jo të ndezshëm, jo toksikë

Mund të shkaktojë asfiksion.



Gaze të ndezshëm

Mund të shkaktojë zjarr ose shpërthime.

Mund të shkaktojë asfiksion.



Substanca oksiduese (gaze)

Mund të shkaktojë reagime të fuqishme ose shpërthime në kombinim me materiale të djegshme. Mund të lehtësojë ndezjen e materialeve dhe do të intensifikojë zjarret.



Gazet toksikë

Rrezik helmimi. Mund të rezultojë në një atmosferë toksike dhe rrezikon shëndetin përmes thithjes së gazit dhe kontaktit me lëkurën.



Lëndë korosive (gaze)

Rreziku i djegieve korosive. Mund të reagojë fuqishëm me ujë ose substanca të tjera. Substancat e derdhura mund të lëshojnë avuj korosivë. Mund të shkaktojë ndryshime të përhershme në indet e lëkurës së njeriut në zonën e kontaktit dhe të shkatërrojë metalet. Mund të dëmtojë sytë, lëkurën dhe traktin respirator



Gazet nën presion

Gaz i kompresuar, i lëngshëm, kriogjenik ose i tretur.

SHENIM: Simbolet e zakonshme të rrezikut janë renditur këtu. Nëse qafa e bombulës suaj të gazit është e shënuar me simbole të tjera, **ju lutemi kontaktoni stafin e Messer-it.**

Si të identifikoni vetitë dhe rreziqet e gazeve në bombula ?

Etiketa shërben për të identifikuar gazin në bombulë. **Lexoni** etiketën e bombulës me kujdes. Përmban simbolet e rrezikut & piktograme. Ajo përshkruan rreziqet dhe masat kryesore që duhen marrë.

Shikoni **ngjyrën e qafës së bombulës**, pasi **ngjyra tregon kodifikimin**. Ngjyra është meënyra e dytë për të identifikuar përmbajtjen e bombulës dhe vetinë e gazit në bombulë.

Ka vende në të cilat kodifikimi bombulave me anë të ngjyrave të mund të ndryshojë nga ato të listuara në tabelën vijuese.

Gazet e zakonshëm

Azot - N₂

UN 1066

Gaz asfikues

Gaz inert, pa ngjyrë, pa erë, jo toksik.

Më i lehtë se ajri.



Gaz jo i djegshëm.

E zezë

Rrezik asfiksimi.

Ajri që thithim zhvendoset në hapësira të mbyllura (rreziku i asfikimit); pa simptoma paralajmëruese para fillimit të humbjes së ndjenjave. Të përdoret vetëm në ambiente të ajrosura mirë.

MOS E THITHNI ATË.

Informacione të mëtejshme:

Shihni Fletën e të Dhënave të Sigurisë Nr. **-N2-089A**

Argon - Ar

UN 1006

Gaz asfikues

Gaz inert, pa ngjyrë, pa erë, jo toksik.

Më i rëndë se ajri.

Gaz jo i djegshëm.



Jeshile e errët

Rrezik asfiksimi.

Ajri që thithim zhvendoset në hapësira të mbyllura (rreziku i asfikimit); pa simptoma paralajmëruese para fillimit të humbjes së ndjenjave. Mblidhet në gropa, kanale, drenazhe dhe zona të ulëta siç janë bodrumet. Të përdoret vetëm në ambiente të ajrosura mirë.

MOS E THITHNI ATË.

Informacione të mëtejshme:

Shihni Fletën e të Dhënave të Sigurisë Nr. **-AR-003A**

Helium - He

UN 1046

Gaz asfikues

Gaz inert, pa ngjyrë, pa erë, jo toksik.

Shumë më i lehtë se ajri.

Gaz jo i djegshëm.



Kafe

Rrezik asfiksimi.

Ajri që thithim zhvendoset në hapësira të mbyllura (rreziku i asfikimit); pa simptoma paralajmëruese para fillimit të humbjes së ndjenjave. Të përdoret vetëm në ambiente të ajrosura mirë.

MOS E THITHNI ATË.

Informacione të mëtejshme:

Shihni Fletën e të Dhënave të Sigurisë Nr. **-HE-061A**

Dioksid Karboni -CO₂

UN 1013

Gaz asfikues

Gaz pa ngjyrë, pa erë,
jo toksik me erë/shije
pak të athët.

Shumë më i rëndë se ajri.

Jo i djegshëm.



Gri

Mblidhet në gropa, kanale, drenazhe dhe zona të ulëta siç janë bodrumet. Gazrat inertë mund të zhvendosin oksigjenin ose ajrin dhe kështu të shkaktojnë asfiksion.

Rreziqet dhe efektet fiziologjike të dioksidit të karbonit janë shumë më komplekse sesa për gazet e tjerë asfikues. Kjo për shkak se përqëndrimet e rritura në ajrin e ambientit ndërhyjnë në proceset natyrale metabolike të frymëmarrjes njerëzore dhe kiminë e gjakut.

Thithja e dioksidit të karbonit mund të ketë rezultate të ndryshme, duke filluar nga një efekt i vogël narkotik deri në humbje të ndjenjave dhe vdekje nëse proporcioni i dioksidit të karbonit në ajër është më i madh se 10%.

Të përdoret vetëm në ambiente të ajrosura mirë.

MOS E THITHNI ATË.

Informacione të mëtejshme:

Shihni Fletën e të Dhënave të Sigurisë Nr.

-CO2-018A

Oksigjeni -O₂

UN 1072

Gaz oksidues

Gaz pa ngjyrë, pa erë,
jo toksik.

Më i rëndë se ajri.

Oksidimi dhe përsheptimi i zjarrit.

Kontakti mund të rezultojë në ndezjen e substancave organike, siç janë yndyrat dhe vajrat organike, kur ato janë në temperaturë ambiente.

Mos hyni në asnjë ambient me përqëndrim të ngritur të oksigjenit.

Përdorni vetëm pajisje të pastra (pa vaj dhe yndyrat) që janë të destinuara për t'u përdorur me oksigjen. **Mos pini** duhan.

Informacione të mëtejshme:

Shihni Fletën e të Dhënave të Sigurisë Nr.

-O2-097A



E bardhë

Acetilen -C₂H₂

UN 1001

Gaz i djegshëm

Gaz pa ngjyrë.

Më i lehtë se ajri.

ngjyrë gështenjë

Formon një përzierje eksplozive me ajrin.

Për shkak të stabilitetit, acetileni tretet nën presion në tretësin DMF (dimetilformamide) ose aceton në bombulë. Futja e një sasive të vogël të energjisë do shkaktojë ndezje në ajër ose oksigjen. **Mos pini** duhan dhe **mos përdorni** mjete që nxjerrin flakë (çakmak etj). Përdorni me kujdes bombulën e gazit në mënyrë që të parandaloni dekompozimin e acetilenit në bombulë. Kjo mund të shkaktojë shpërthimin e bombulës për shkak të efekteve të nxehtësisë ose presionit të tepërt.

MOS E THITHNI ATË.

Informacione të mëtejshme:

Fleta e të Dhënave të Sigurisë Nr.C2H2-001



Hidrogjen - H₂

UN 1049

Gaz i djegshëm

Gaz pa ngjyrë, pa erë,
jo toksik.



Me i lehtë seajri

E kuqe

Akumulohet në pikën më të lartë në hapësirat
e mbyllura që nuk janë ventiluar mirë.

Djeg me një flakë jo shumë të dukshme.

Mos pini duhan dhe **mos përdorni** mjete që
nxjerrin flakë (çakmak etj).

MOS E THITHNI ATË.

Informacione të mëtejshme:

Shihni Fletën e të Dhënave të Sigurisë Nr.
-H2-067A

Propan/butan

UN 1965

Gaz i djegshëm

Jo toksik, i lëngshëm.

Më i rëndë se ajri.



kur është në sasi të mëdha ka efekt asfiksues.

Si shumë gaze, propani / butani është pa
erë. Prandaj, një aromë e fuqishme i shtohet
asaj përpara dorëzimit në mënyrë që të jetë
e mundur të zbulohen rrjedhjet e gazit.

Mbajini bombulat e gazit larg ngrohësve ose
burimeve të tjera të nxehtësisë. **Do not**
smoke and **do not** use an open flame.

MOS E THITHNI ATË.

Informacione të mëtejshme:

Shihni Fletën e të Dhënave të Sigurisë Nr.
-C3H8-C4H10-01



Ju mund të kërkoni
udhëzues shtesë **xhepi për
sigurinë** në faqen tonë të
Internetit ose t'i merrni ato
direkt nga ekspertët tanë.



E rëndësishme

Ky udhëzues xhepi përmban vetëm informacione të përgjithshme. Nuk zëvendëson trajnimet dhe nuk është menduar si i tillë. Messer nuk mban përgjegjësi për informacionet që përmban kjo broshurë.